

STATUTI dhe AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ART DESIGN SOLUTION” Sh.p.k

Mbeshtetur ne ligjin nr.9901 date 14/04/2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare”, ne ligjin Nr.9723 date 03/05/2007 “Per QKR”, sot me date 09 Gusht 2022 me vullnetin e lire e te plote vendosem te krijojme dhe miratojme statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “ART DESIGN SOLUTION” Sh.p.k, me kete permbajtje

I.-DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sot me date 09 Gusht 2022 ne, themeluesit, ne mbeshtetje te legjistacionit Shqiptar, kryesisht ne ligjin nr.9901 dt. 14/04/2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare”, i ndryshuar dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi ka perpiluar dhe nenshkruar statutin e Shoqerise si me poshte vijone :

Neni 1-Forma

Shoqeria “ART DESIGN SOLUTION” shpk eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e se ciles do te rrgullohet me ane te ketij Statuti dhe nga legjistacioni ne fuqi. Ky statut eshte perpiluar ne perputhje me legjistacionin shqiptar dhe ka karakter te detyrueshem per nenshkruesit e tij, çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne te plotesohen nga legjistacioni shqiptar.

Shoqeria me pergjegjesi te Kufizuar “ART DESIGN SOLUTION” Sh.p.k, krijohet nga ortakët e saj,

Z. Qamil Pajolli, shtetas shqiptare i identifikuar me karte indentiteti nr. G70228071J, i biri i Shaban, i datelindjes 28/02/1967, lindur ne Lushnje banues ne adresen: Lagjja “Xhevdet Nepravishta” Lushnje

Neni 2 - Emertimi

Emertimi i shoqerise eshte “ART DESIGN SOLUTION” Sh.p.k.

Neni 3 - Selia

Shoqeria “ART DESIGN SOLUTION” e ka seline ne adresen: Njesia nr.6,Rruga,"Sami Frasher",Nr.pasurie 2/531,Zona kadastrale 8270,Tirane.

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete mbi 10(dhjete) vjet. Ky afat mund te zgjatet me vendim te ortakeve te saj themelues ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

II.-OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

Objekti i Veprimtarise se Shoqerise “ART DESIGN SOLUTION” Sh.p.k, do te jete :

Prodhim,tregtim,vendosje dhe riparime,dyer-dritare te cdo lloji,Import-ksport.Mirëmbajtje te Objekteve dhe sistemeve te aluminit, riparime dhe rinovime, lysterje, punime elektrike, punime hidraulike, instalime,vendosje parketi etj.Sherbime marketingu dhe telemarketingu, pergatitje dhe prodhim i materialeve promocionale, dixhitale dhe te fushes se informatikes, komisioner i te gjitha sherbimeve te lidhura me to, brenda dhe jashte vendit.Zbatim dhe ndertim te objekteve per punime dheu,



murature, punime betoni, punime shembje dheu. Ndertime civile, turistike, bujqesore, industriale. Punime ujesjellesi e kanalizime, impjante publike ne te gjitha fushat. Rikonstruksione godinash etj.

Shoqeria mund te marre pjese ne menyre te drejtperdrejte ose terthorte ne cdo shoqeri qe ka objekt te ngjashem apo qe lidhet me objektin e shoqerise. Shoqeria mund te angazhohet gjithashtu ne cfaredo lloji aktiviteti tjeter qe nuk ndalohet me ligj.

Neni 6

Shoqeria ka te drejte te shtoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te Ortakeve te saj.

Neni 7

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te krijojë filiale, dege e perfaqesi brenda e jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendeve ku do te ushtroje veprimtarine.

Neni 8

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likujditetit. Per detyrimet e veta Shoqeria pergjigjet me pasurine e saj.

III-MJETET E SHOQERISE

Neni 9

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte ne vleren **100.000 (njeqind mije) Leke**. Kapitali i shoqerise eshte ndare ne kuota sipas pjesemarrjes ne perqindje per secilin ortak.

Kapitali themeltar i shoqerise zoterohet si me poshte :

1. Z.Qamil Pajolli, Me cilesine e ortakut themelues, zoteron nje kuote ne vleren 100.000 (njeqindmije) leke, e barabarte me 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 10

Kapitali i Shoqerise mund te shtohet me vendim te ortakeve te saj, vendim i cili duhet te depozitohet ne zyren perkatese. Aktiviteti ne kete shoqeri nuk i pengon ortakët te kene te drejta pronesie dhe aktivitet jashte kesaj shoqerie.

IV.-ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 11

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj duke u bazuar ne kete Statut dhe ne ligjet ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.

Neni 12

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me mjetet e saj financiare, me mjete e kredi te akorduara ne menyre te ligjshme. Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes se vet ta ushtroje ne vartesi te shumes se mjeteve te investuara dhe te shumes se mjeteve te rezervuara.

Neni 13

Shoqeria gezon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka te drejte ti perdore ato ne perputhje me objektin dhe qellimin e veprimtarise se saj.

Neni 14

Kapitali themeltar i shoqerise dhe kapitali i mevonshem mund te krijojë nje fond te vecante , qe mund te mbetet ne llogarine bankare te shoqerise. Fondet monetare te shoqerise do te perdoren ne perputhje me kete statut te shoqerise dhe ligjet ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.

Neni 15

Shoqeria do te celi llogari ne banke. Ajo do te mbaje llogarine duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar, ne euro, usd e monedha te tjera te huaja. Veprimet bankare do te kryhen nga ana e ortakeve dhe administratoret e saj.

Neni 16

Shoqeria do te krijoje keto fonde: Fondi Themeltar, Fondi Rezerve , Fondi i Shperblimit. Per zhvillimin e veprimtarise se vet shoqeria mund te krijoje edhe fonde te tjera. Fondi themeltar i shoqerise formohet nga Kapitali Themeltar si dhe mjetet qe do krijohen gjate aktivitetit ekonomik te saj.

Neni 17

Shoqeria shfrytezon fondin Themeltar per ushtrimin e veprimtarise se vet per investime te ndryshme ne interes e realizimit te qellimit te shoqerise, si dhe per te mbuluar rreziqet mbas shfrytezimit te fondit rezerve. Fondin Themeltar shoqeria mund ta shfrytezoje edhe per destinacione te tjera te veprimtarise se saj afariste.

Neni 18

Fondi Rezerve i shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit, qe ajo realizon gjate veprimtarise se saj, qe percaktohet me nje vendim te vecante te Ortakeve te saj. Fondi Rezerve shfrytezohe per te mbuluar humbjet dhe rreziqet.

V.-ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 19

Organet drejtuese te shoqerise:

-Ortaket e shoqerise .

-Administratori i shoqerise per nje afat 5 (pese) vjet do te jete **Z. Qamil Pajolli**, shtetas shqiptare i identifikuar me karte indentiteti nr. G70228071J, i biri i Shaban, i datelindjes 28/02/1967, lindur ne Lushnje banues ne adresen: Lagjja "Xhevdet Nepravishta",banes private,Lushnje

Neni 20

Ortaket e shoqerise ushtrojne keto funksione : Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit te veprimtarise se shoqerise dhe aktet e pergjithshme, vendime per ndryshimin e emertimit te shoqerise, te cilesise se saj, te objektit te veprimtarise, per shtim ortakesh , ndryshim administrator. Vendos per rritjen ose pakesimin e kapitalit themeltar te shoqerise,miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar te shoqerise, vendos per ndryshimin e formes se organizimit te shoqerise. Vendos per mbylljen e veprimtarise dhe caktimin e likujdatoreve.Te gjitha keto funksione do te kryhen ne perputhje me ligjin "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit "Per regjistrin tregtar".

Neni 21

Administratori i shoqerise ka keto detyra:

Organizimin e drejtimin e punes dhe veprimtarise se shoqerise, perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet. Mban pergjegjesi per zbatimin e ligjeve ne shoqeri si dhe per aktivitetin ekonomik te saj. Pergatit aktet qe jane kompetence te ortakeve te shoqerise. Merret me organizimin dhe drejtimin e shoqerise si dhe percakton strukturen, numrin, kualifikimin e punonjesve te shoqerise,perfaqeson shoqerine ne lidhjen e kontratave dhe kryen veprime te tjera juridike qe nuk jane kompetence te ortakut te vetem.

Neni 22

Ne mungese apo ne pamundesi te ushtrimit te funksionit te administratorit ate e zevendeson nje punonjes tjeter, qe caktohet nga ai vete me shkrim.



VI.-MENYRA DHE KUSHTET E PERDORIMIT TE FITIMIT.

Neni 23

Pas perballimit te detyrave qe ka shoqeria, taksave, tatimeve, pagave te punonjesve dhe shpenzimeve te tjera, fitimi neto i shoqerise qe i perket ortakeve te saj, mund ta perdorin ate lirisht sipas deshires se vet.

VII.-MARREDHENIET E PUNES DHE PERGJEGJESIA.

Neni 24

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete Statut dhe Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise. Shoqeria lidh kontraten per marrjen ne pune te punonjesve sipas Kodit te Punes.

Neni 25

Punonjesi ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen me profesionalizem dhe disipline te punes. Ortaket, administratori dhe punonjesit e shoqerise jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, njohurive e pervojës se fituar e shkëmbyer ne kuadrin e shoqerise, fshehtesine e gjendjes financiare dhe burimeve te mallrave, identitetin e shumave e te ardhurave te saj, depozitave, te dhena te tjera qe organizimin e orientimin e shoqerise i konsideron sekrete te punes. Te dhenat e punes qe paraqesin sekretet e punes mund te behen te njohura peronave te tjere me lejen e administratorit te shoqerise. Detyrimi per ruajtjen e sekretit vazhdon edhe pas nderprerjes se marrdhenieve te punes me shoqerine.

VIII.-MBYLLJA E SHOQERISE.

Neni 26

Ne qofte se humbjet e shoqerise nuk mund te perballohen me mjetet e ortakeve te kesaj shoqerie, te vena me rastin e themelimit te shoqerise, hapet procedura e likujdimit te shoqerise.

Neni 27

Shoqeria mund te shperndahet me likujdimin e saj. Ne rastin e likujdimit te shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeria ne likujdim e siper". Ne rast shperndarje te shoqerise, administratori vendos per menyren e likujdimit, ortaket caktojne nje ose disa likujdator, te cilet bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje detyrimet, qe ka ndaj personave te trete.

Neni 28

Kur shoqeria pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen detyrimet qe ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurat i mbeten ortakeve te saj.

Neni 29

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Bilanci vjetor i shoqerise duhet te shqyrtohet dhe miratohet brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

Neni 30

Ne rast vdekje te ortakeve, pasuria e tyre i kalon ne pronesi trashegimtareve ligjor ne perputhje me dispozitat ligjore per trashegimine. Administratori i shoqerise ka te drejte te emeruje avokat dhe ekonomist si dhe t'ju japi te drejta personave te tjere, qe veprojne ne emer dhe per llogari te tij sipas ligjeve ne fuqi.

IX.-DISPOZITAT E FUNDIT.

Neni 31

Shoqeria deklarohet e krijuar me vendimin e Ortakeve te shoqerise. Nga kjo dite fiton statusin e Personit Juridik.



Neni 32

Ndryshimet ne kete statut behen ne te njeten menyre e procedure me te cilen nxirret ky statut duhe zbatuar dispozitat ligjore perkatese.

Neni 33

Mosmarreshjet ne shoqeri do te zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet do te zgjidhen prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor te qytetit ku i takon.

Neni 34

Ky Statut u perpilua ne pese kopje per tu administruar sipas ligjit.

ORTAKET THEMELUES

QAMIL PAJOLLI

